



BASHKIA FUSHË-ARRËZ



# PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ

P ë r m b l e d h j e

**Përgatitur nga:** BASHKIA FUSHË ARRËZ

**Mbështetur nga:** Intercooperation Albania, Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor ( dldp )  
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Shqipëri  
URBAPLAN, Zvicer

**Financuar nga:** SDC – Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

**Fushë Arrëz - 2008**

**Realizimi Grafik:** CREOstd

**Shtypur në:** Botime AFROJDIT



Schweizerische Eidgenossenschaft Swiss Cooperation Office Albania  
Confédération suisse  
Condeferazione Svizzera  
Confederaziun svizra

## Tabela e Përmbajtjes

Hyrje .....	4
Fjala e Përshëndetjes .....	5
Çfarë është dhe çfarë përfaqëson PSZh për Bashkinë Fushë-Arrëz? .....	6
Profili i Bashkisë Fushë-Arrëz .....	7
Bashkia Fushë-Arrëz në Kontekstin Rajonal .....	9
Drejtimet e Zhvillimit nga Grupi i Qytetarëve .....	10
Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz .....	11
Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Bashkinë Fushë-Arrëz .....	12
Zhvillimi Ekonomik .....	13
Menaxhimi i Territorit .....	14
Infrastrukturat dhe Shërbimet .....	14
Qeverisja e Mirë Vendore .....	16
Zhvillimi i Burimeve Financiare në Bashkinë Fushë-Arrëz .....	17
Instrumentat e Menaxhimit të Territorit .....	18
Forma dhe Metodologjia e Zbatimit të PSZH .....	21

## Hyrje

Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz paraqitur në këtë dokument vjen në kuadër të **Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (PDZHL)** në rajonin e Shkodrës, në Veri të Shqipërisë.

Bashkia Fushë-Arrëz është një ndër tetë njësitë partnere të qeverisjes vendore përfutuese të këtij Programi, krahas Bashkisë Shkodër, Bashkive Vau i Dejës, Pukë, Koplík, dhe Komunave Velipojë, Dajç dhe Guri i Zi.

Ky Program synon drejt përmirësimit të qeverisjes në nivelin vendor, kryesisht përmirësimit të strukturave të menaxhimit dhe administrimit, duke mbështetur proceset e decentralizimit të pushtetit si edhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm për njësitë e zgjedhura vendore nëpërmjet bashkërendimit të zhvillimit urban, mbrojtjes së mjedisit dhe promovimit të pjesëmarrjes së publikut në vendimarrje.

Hartimi i Strategjive të Zhvillimit nëpërmjet proceseve përgatitore transparente me pjesëmarrjen e qytetarëve përbën një nga komponentët kryesorë të Programit. Qëllimi i këtij procesi është të pajisë autoritetet vendore përkatëse me një dokument bazë strategjik i cili identifikon prioritetet kyç të zhvillimit për njësinë vendore përfutuese si dhe orienton zhvillimin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen e shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit etj.

Strategjia e Zhvillimit për Bashkinë Fushë-Arrëz është hartuar dhe përshtatur përgjatë një procesi të hapur, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të drejtorive kryesore në Bashkinë Fushë-Arrëz si dhe të Grupit të Qytetarëve, të cilët janë përfshirë në një cikël seminaresh debatuuese dhe procesesh të hapura këshillimore.





## Fjala e Përshëndetjes



Ndryshimet e mëdha e të shumta politike, ekonomike dhe shoqërore që pasuan pas lëvizjeve demokratike të viteve 1990 në vendin tonë kanë dhënë një efekt të ndjeshëm dhe të dukshëm edhe në Bashkinë Fushë Arrëz, në drejtim të menaxhimit të pushteteve dhe sistemeve të reja të krijuara.

Për t'ju përgjigjur sfidave të reja të zhvillimit, Bashkia Fushë-Arrëz, nepermjet mbështetjes së Intercooperation Albania me qendër në Shkodër, financimit të Qeverisë Zvicerane, si dhe të orientuar me profesionalizëm dhe përkushtim nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, ka finalizuar me sukses dokumentin e Planit Strategjik të Zhvillimit.

Ky Plan është dhe do të mbetet një dokument shumë i rëndësishëm në duart e qytetarëve të Fushë Arrëzit, të bizneseve dhe në mënyrë të veçantë të Këshillit Bashkiak dhe administratës vendore, për t'u orientuar në të ardhmen në hartimin e buxheteve, përcaktimin e prioritetëve dhe mbështetjen ndaj bizneseve, drejt sfidave dhe zhvillimeve të reja. Në këtë dokument janë analizuar kushtet aktuale, mundësitë e zhvillimit dhe masat që duhet të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen ekonomike, sociale dhe infrastrukturat e nevojshme në Bashkinë Fushë-Arrëz. Hartimi i këtij Plani Strategjik Zhvillimi për Bashkinë Fushë-Arrëz do të shërbejë si dokument bazë dhe si pikënisje në rrugën e gjatë të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë, jetës shoqërore dhe ambientit në zonën tonë dhe më gjerë.

Gjej rastin të falenderoj për zemërsisht grupin qytetar, intelektualët, këshilltarët dhe administratën që punuan afërsisht një vit për hartimin e Planit, duke hedhur idetë dhe mendimet e tyre për mundësitë e zhvillimit të zonës. Nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me njëri-tjetrin dhe me Co-PLAN u bë e mundur përgatitja e këtij dokumenti që është i pari në llojin e vet dhe do të shërbejë për krahasimin dhe monitorimin e zhvillimit të zonës sonë gjatë viteve.

Me respekt!

**NDUE PALUCA**

Kryetari i Bashkisë Fushë-Arrëz

## Çfarë është dhe çfarë përfaqëson Plani Strategjik i Zhvillimit për Bashkinë Fushë-Arrëz?

**Një kuadër i ri orientimi pune:** Që prej formimit dhe konsolidimit si Bashki, është hera e parë që administrata vendore në Fushë-Arrëz prodhon strategjinë e saj të zhvillimit, duke shënuar një moment të rëndësishëm që shtron rrugën për një qasje të organizuar dhe të planifikuar të aktiviteteve të saj në të ardhmen.

**Procese të Reja:** Ky Plan, si një mekanizëm institucional, përcakton agjendën për zhvillimin e ardhshëm të zonës, politikat dhe veprimet e nevojshme për t'u ndërmarrë. Në këtë kuadër, ai nuk është vetëm një produkt por mbi të gjitha një proces që bazohet në nevojat, prioritetet dhe potencialet e identifikuara dhe diskutuara gjatë procesit konsultues me përfaqësuesit kryesorë vendorë.

**Një Plan Vizionar i Kombinuar:** Praktika e planifikimit në Shqipëri ka njohur kryesisht plane të formës së Masterplaneve, Planeve të Përgjithshëm Rregullues ose dokumenteve strategjikë të zhvillimit (p.sh. strategji zhvillimi të një qyteti apo të një zone të caktuar). Ky Plan Strategjik Zhvillimi është një ndërthurje e elementit strategjik (vizionar) me atë territorial (fizik) dhe administrativ, pra një kombinim objektivash dhe ndërhyrjesh në të gjitha fushat dhe përgjegjësitë që ka qeverisja vendore.

**Një paketë/skenar e/i qartë veprimesh:** Strategjia e Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz ndërton një kuadër nismash dhe veprimesh konkrete përcaktuar aktivitete e duke skeduar përgjegjësitë dhe afatet kohore në nivel vendor. Në këtë mënyrë ajo përkthen përparësitë vendore, mat punën e administratës, vë në dispozicion burimet për të siguruar dhe racionalizuar më tej financimet sipas një kuadri koherent, qartëson dhe përcakton investimet e nevojshme dhe, më e rëndësishmja, mundëson realizimin e pritshmërive të ndryshme.

**Një Instrument për Zhvillimin e Territorit:** Dokumenti i PSZh-së propozon veprime për identifikimin e formave të përdorimit të tokës si edhe kuadrin rregullues; këto pasqyrojnë orientimin teknik në lidhje me transformimin e infrastrukturave apo modeleve të përdorimit të tokës në të ardhmen.



## Profili i Bashkisë Fushë-Arrëz



Fushë-Arrëzi është një Bashki e vogël merreth 4,800 banorë, në zonën veriperëndimore të Shqipërisë, e cila ndodhet përgjatë rrugës kombëtare Shkodër-Kukës-Prishtinë. Bashkia Fushë-Arrëz bën pjesë në Rrethin e Pukës dhe kufizohet nga verilindja me Kukësin dhe nga jugperëndimi me Pukën; ndërsa brenda Qarkut kufizohet në veri me Komunën Qafë Mali, në jug me Komunën Rrapë, në lindje me komunën Qafë Mali dhe në perëndim me Komunën Qelëz.

Bashkia Fushë-Arrëz shtrihet në një zonë malore, me një sipërfaqe prej 2,360 Ha, pjesa më e madhe e së cilës, 2,274 Ha, është sipërfaqe pyjore. Një pjesë e vogël e territorit të saj administrativ prej 18 Ha përbehet nga qyteti i Fushë-Arrëzit, ndërsa tre fshatrat Fushë-Arrëz, Micoj dhe Lumardhë, zënë një sipërfaqe prej 68 Ha tokë are.


Pasuritë natyrore të Fushë-Arrëzit, kryesisht ato nëntokësore, të shprehura në rezervat e mëdha minerale të shfrytëzueshme për periudha afatgjata, pasuritë mbitokësore, si fondi i pasur pyjor, të kombinuara me një klimë malore të pastër dhe kuruese, janë veçori përcaktuese në llojin e zhvillimit të deritanishëm të Fushë-Arrëzit dhe gjithashtu përparësi që mbështesin zhvillimin në të ardhmen.

### Pozicioni gjeografik i Bashkisë Fushë-Arrëz

Qyteti i Fushë-Arrëzit e mori këtë emër nga fshati Fushë-Arrëz në vitet '50, periudhë gjatë së cilës kishte filluar aktiviteti industrial i prodhimit dhe përpunimit të lëndës drusore dhe përpunimit të bakrit, të cilat kanë qenë dhe janë aktivitetet kryesore ekonomike.



Nr.	Emri	Vlera / karakteristika
1	Statusi Ligjor dhe Administrativ	Bashki
2	Vendndodhja	Qarku Shkodër
3	Sipërfaqja totale	23.6km <sup>2</sup>
4	Numri i qyteteve	1
5	Numri i fshatrave	2
6	Numri i banorëve	4, 800
7	Numri i familjeve	1175
8	Popullsia në gjendje fizike pune	42%
9	Buxheti Vjetor - 2008	28,439,000 Lekë
10	Të Ardhurat Vendore të Pritshme - 2008	7,500,000 - 8,000,000 Lekë
11	Numri i bizneseve private	80
12	Niveli i papunësisë	30%
13	Numri i të punësuarve në sektorin shtetëror	135
14	Numri i të punësuarve në sektorin privat	Nuk ka të dhëna të sakta
15	Niveli i emigracionit	Nuk ka të dhëna të sakta
16	Gjatësia totale e rrugëve	15km
17	Numri i Ndërmarrjeve Publike	3
18	Numri i rrjeteve të ujësjellës-kanalizimeve	1
19	Numri i të punësuarve në Bashki	17
20	Numri i institucioneve parashkollore	4
21	Numri i shkollave fillore - nëntëvjeçare	3
22	Numri i shkollave të mesme	1
23	Numri total i nxënësve	1300
24	Numri i qendrave shëndetësore	3
25	Numri i spitaleve	0
26	Numri i qendrave të këshillimit	0
27	Numri i qendrave për të moshuar	0
28	Aktivitetet kryesore ekonomike	Prerje dhe përpunim druri
		Nxjerrje mineralesh
		Dyqane dhe njësi tregtare
		Njësi shërbimi dhe servise
		Mbledhje bimësh mjekësore
29	Dokumente zhvillimi dhe strategji	Strategjia e Zhvillimit Rajonal
		Plani i Menaxhimit të Mbeturinave
30	Nevojat kryesore në Infrastrukturë	Përmirësimi i rrjetit të brendshëm të ujësjellës-kanalizimeve
		Ndërtimi i pikës së trajtimit të ujërave të zeza të qytetit
		Përmirësimi i hapësirave të brendshme të qytetit
		Asfaltimi i unazës së qytetit
		Sistemimi i rrugëve të fshatrave
Rehabilitimi i banesave të braktisura		







## Bashkia Fushë-Arrëz në Kontekstin Rajonal

Sfidat e zhvillimit të periudhës 17-vjeçare të transicionit kanë evidentuar nevojën e ripërcaktimit të rolit të Fushë-Arrëzit me synim rritjen e aftësisë së tij për t’u integruar dhe përshtatur me zhvillimet dhe tendencat e shfaqura dhe njëkohësisht për t’u përgjigjur konkurrencës në kontekstin rajonal më mirë dhe më shpejt.

Në çdo rast, Bashkia e Fushë-Arrëzit nuk mund të konsiderohet e shkëputur nga bashkitë përreth në kuadër të një zhvillimi rajonal në të ardhmen. Në këtë drejtim, duhen mbajtur parasysh thellimi i decentralizimit në vend dhe tendencat drejt rajonalizimit në zhvillimin e ekonomive vendore, pra orientimi rreth elementeve zhvillues të përbashkët ndërmjet njësive të ndryshme vendore.

Aktualisht, Bashkia Fushë-Arrëz identifikon nevojën për harmonizimin e përpjekjeve për bashkëpunim në disa fusha dhe aktivitete potenciale ekonomike, në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të avantazheve të përbashkëta dhe zgjidhjes së problematikave që shkojnë përtej kufijve të saj administrativë.

Zhvillimi i turizmit malor në Fushë-Arrëz, i identifikuar si një potencial ekonomik i rëndësishëm në zona si Krrabë, Munellë etj., si dhe grumbullimi i bimëve mjekësore dhe prodhimeve të dyta pyjore, janë dy sektorë potencialë të cilët mund të shihen të ndërthurur me përpjekje të ngjashme në Pukë dhe në Shkodër.

Nga ana tjetër, disa probleme të caktuara që ekzistojnë në nivel qarku si depozitimi i mbeturinave në përputhje me standardet mjedisore apo mbrojtja e pyjeve dhe ekosistemeve në tërësi, prekin njëkohësisht Fushë-Arrëzin dhe Pukën dhe, për këtë arsye, kërkojnë zgjidhje të përbashkëta dhe të koordinuara.

Një zhvillim i rëndësishëm në nivel kombëtar apo rajonal është ndërtimi i rrugës së re (autostradës) Durrës-Morinë. Kjo rrugë vlerësohet se mund të ketë një ndikim jo të favorshëm në perspektivë për Fushë-Arrëzin, pasi do të zvogëlojë trafikun përgjatë rrugës ekzistuese interurbane, i cili është edhe gjeneruesi i aktiviteteve kryesore për Bashkinë.

## Drejtimit e Zhvillimit nga Grupi i Qytetarëve

Në dy fazat e para të projektit për përgatitjen e Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz, me pjesëmarrjen e grupit të qytetarëve u identifikuan disa drejtime të mundshme të zhvillimit të zonës, të bazuara në tiparet karakteristike të saj, historikun dhe traditën e mëparshme të ecurisë së zhvillimit por edhe në zhvillimet më të fundit strategjike në nivel rajonal, të cilat do të mund t'i hapin qytetit dhe fshatrave përreth tij një dimension të ri zhvillimi.

Drejtimit kryesore të cilat mund të orientojnë zhvillimin e Bashkisë Fushë-Arrëz në të ardhmen vijojnë si më poshtë:

1. Promovimi dhe zhvillimi i industrisë së përpunimit të drurit duke marrë për bazë pasuritë natyrore pyjore të Fushë-Arrëzit si dhe traditat e zonës.
2. Zhvillimi i Turizmit Malor si një oportunitet i mundshëm për shkak të karakteristikave dhe vlerave natyrore malore që paraqet i gjithë territori i rrethit të Pukës.



## Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz



Fushë-Arrëzi si një qendër e vogël dhe e ripërtërirë urbane, e përfshirë në realitetin e zhvillimeve të ardhshme rajonale në veri të Shqipërisë; një pikë qëndrimi dhe çlodhëse për njerëzit, aktivitetet e ndryshme ekonomike dhe shërbimet midis Shkodrës dhe Kosovës;

Fushë-Arrëzi si një qytet i ripërtërirë ekonomikisht që mbështetet në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe potencialeve pyjore dhe në turizmin malor.

Fushë-Arrëzi si Bashki me burime njerëzore të kualifikuara, si në nivelin e administratës vendore ashtu edhe në strukturat e sipërmarrjes së biznesit, kulturës, sportit dhe arsimit, që nxisin krijimin e një klime të favorshme për biznesin vendas dhe të huaj dhe mundësitë për punësim e një rritje të qëndrueshme të të ardhurave për banorët;

Fushë-Arrëzi një vend i sigurt, i pastër dhe tërheqës për banorët dhe komunitetet në rritje, të cilët kanë mundësi të përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien e tyre në bashkëveprim dhe me sens qytetar dhe kanë kapacitetin dhe shtysën për të dhënë kontribut efektiv në të ardhmen e bashkisë dhe qytetit.



## Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Bashkinë Fushë-Arrëz

### **A. NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK**

Zhvillimi ekonomik i Bashkisë Fushë-Arrëz duke u përqendruar në përmirësimin e klimës së biznesit, promovimin e aktiviteteve vendore të sipërmarrjes dhe krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët e huaj.

### **B. NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË TERRITORIT**

Konsolidimi i qendrës urbane të qytetit të Fushë-Arrëzit si dhe përmirësimi i cilësisë së hapësirave të brendshme urbane në funksion të promovimit dhe zhvillimit të karakterit turistik malor të qytetit.

### **C. NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE**

Rritja e cilësisë së shërbimeve publike dhe infrastrukturës fizike e sociale në të gjithë territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz.

### **D. NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË QEVERISJES VENDORE**

Rritja e kapaciteteve menaxhuese dhe administruese të pushtetit vendor në Bashkinë Fushë-Arrëz.

### **F. NË FUSHËN E RRITJES SË TË ARDHURAVE VENDORE**

Përmirësimi i të ardhurave vendore në Bashkinë Fushë-Arrëz duke rritur kështu mundësinë për investime në të ardhmen.



## Zhvillimi Ekonomik

### **Mbështetjen dhe zhvillimin e prodhimit dhe të aktiviteteve bujqësore vendore**

- a. Evidentimi i potencialeve të prodhimit të këtyre kulturave bujqësore në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz
- b. Përmirësimi i përdorimit të tokës dhe infrastrukturave mbështetëse nëpërmjet një studimi për vlerësimin e nevojave për investime
- c. Rritja e mbështetjes teknike dhe financiare ndaj fermerëve vendas në Fushë-Arrëz

### **Mbështetjen dhe zhvillimin e Turizmit Malor duke u bazuar në karakteristikat natyrore të veçanta të Bashkisë Fushë-Arrëz**

- a. Nxitja dhe Zhvillimi i aktiviteteve turistike në këtë Bashki

### **Promovimin dhe zhvillimin e Aktiviteteve Ekonomike në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz**

- a. Vendosja e bashkëpunimit me komunat fqinje si edhe me Qarkun e Shkodrës me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve ekonomike
- b. Përgatitja e projekteve të detajuara për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike
- c. Mbështetja me investime konkrete

## Menaxhimi i Territorit

### Mbrojtja e tokës bujqësore dhe ndalimi i ndërtimeve në të

- a. Rritja e nivelit të kontrollit mbi ndërtimet e reja (Inspektorati i Ndërtimit) në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz
- b. Prezantimi dhe konsolidimi i masave penalizuese si dhe njohja e komunitetit vendor me këto masa
- c. Identifikimi i politikave fiskale të posaçme për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe pyjeve dhe orientimi i ndërtimeve në këto territore

### Rigjallërimi i territoreve ekzistuese të dëmtuara nga aktiviteti njerëzor si dhe mbrojtja e mjedisit në Bashkinë Fushë-Arrëz

- a. Identifikimi i zonave që kanë nevojë për ndërhyrje përmirësuese në mjedis
- b. Përmirësimi i gjendjes së mjedisve të dëmtuara (ndotura) në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz

## Infrastrukturat dhe Shërbimet

### Përmirësimin e gjendjes së rrjetit rrugor në Bashkinë Fushë-Arrëz

- a. Hartimi i projekteve të ndërhyrjes në rrjetin rrugor të qytetit dhe të fshatrave të Bashkisë Fushë-Arrëz
- b. Kryerja e investimeve përmirësuese për rrjetin rrugor të qytetit



**Përmirësimi i gjendjes së ujësjellës-kanalizimeve në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz**

- a. Përmirësimi i kushteve teknike dhe menaxhuese të drejtorisë së Ujësjellës-Kanalizimeve në Bashkinë Fushë-Arrëz
- b. Përmirësimi i gjendjes fizike të rrjetit të ujësjellës-kanalizimeve në territorin e Bashkisë
- c. Rritja e kapaciteteve të stafit të ndërmarrjes për menaxhimin dhe administrimin e saj

**Përmirësimi i gjendjes së grumbullimit dhe depozitimit të mbeturinave urbane**

- a. Identifikimi i një pike për depozitimin e mbeturinave

**Përmirësimi i gjendjes së shkollave dhe kopshteve në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz**

- a. Evidentimi i nevojave për përmirësime fizike në shkollat e Bashkisë Fushë-Arrëz
- b. Përgatitja e projekteve teknike për financime të mundshme nga sektori shtetëror apo donatorë të ndryshëm
- c. Nxitja e forumeve vendore lidhur me mundësinë e rritjes së cilësisë së mësimdhënies në shkollat e bashkisë

**Gjelbërimi i mjediseve në Bashkinë Fushë-Arrëz**

- a. Përmirësimi i kushteve fizike të mjediseve të gjelbra në territorin e Bashkisë

#### **Ndriçimi i rrugëve**

- a. Përmirësimi i gjendjes së ndriçimit rrugor në Bashkinë Fushë-Arrëz

#### **Mirëmbajtja e Varrezave Publike**

- a. Zgjerimi dhe përmirësimi i kushteve aktuale të varrezave publike

#### **Dekorimi i qytetit**

- a. Përmirësimi i imazhit të qytetit dhe dekorimi i tij

#### **Rritja e shkallës së punësimit në Bashkinë Fushë-Arrëz.**

- a. Rritja e kapaciteteve të banorëve vendas në Bashkinë Fushë-Arrëz
- b. Organizimi i punësimeve periodike për grupet në nevojë

## **Qeverisja e Mirë Vendore**

#### **Rritja e kapaciteteve të Bashkisë Fushë-Arrëz**

- a. Riorganizimi administrativ i Bashkisë Fushë-Arrëz
- b. Rritja e kapaciteteve teknike të stafit të Bashkisë

#### **Përmirësimi i transparencës në proceset vendore të vendimmarrjes**

- a. Shpërndarja zyrtare e informacionit lidhur me aktivitetet e Bashkisë Fushë-Arrëz
- b. Nxitja e pjesëmarrjes qytetare dhe informimi në mbledhjet e këshillit bashkiak

#### **Zhvillimi i buxhetimit me pjesëmarrje në bashkinë Fushë-Arrëz**

- a. Ngritja e kapaciteteve vendore për organizimin e Buxhetimit me Pjesëmarrje në Fushë-Arrëz
- b. Organizimi i aktiviteteve vjetore periodike të Buxhetimit me Pjesëmarrje në Bashkinë Fushë-Arrëz



## Zhvillimi i Burimeve Financiare në Bashkinë Fushë-Arrëz

### **Rritjen e të ardhurave Vendore të Bashkisë**

- a. Krijimi dhe konsolidimi i bazës së të dhënave për rritjen e bazës së taksave dhe tarifave në Bashkinë Pukë

### **Promovimi dhe rritja e investimeve të vendit dhe të huaja**

- a. Përgatitja e materialeve promovuese për bashkinë Fushë-Arrëz
- b. Organizimi i evenimenteve të ndryshme në mbështetje të biznesit në Bashkinë Fushë-Arrëz

### **Evidentimi dhe shfrytëzimi i burimeve të tjera financiare për Bashkinë Fushë-Arrëz**

- a. Përgatitja e projekt-propozimeve

## Instrumentat e Menaxhimit të Territorit

Siç është identifikuar edhe në përmbledhjen e profilit të bashkisë, në Kapitullin II, Bashkia Fushe Arrëz ka një dinamikë të papërfillshme për sa i përket zhvillimeve hapësinore. Rënia graduale e popullsisë, si indikator i zhvillimit të ulët social ekonomik të zonës, shoqërohet në të njëjtën kohë me një kërkesë shumë të ulët për ndërtime të reja, apo transaksione të tokës. Si rrjedhim, propozimet në këtë aspekt janë kufizuar në identifikimin formal të formave të zhvillimit të secilës zonë urbane në qytezën e Fushë Arrëzit, pa marrë në konsideratë fshatrat Micoj dhe Lumardhë. Kjo ndërhyrje është konceptuar si një minimum i domosdoshëm për administratën e Bashkisë Fushë Arrëz për të menaxhuar territoret urbane. Në këtë kuadër, në materialin grafik identifikohen:


**Zona e rehabilitimit mjedisor:** kjo njollë konturon territorin në të cilin shtrihen dampat e derdhjes së mbeturinave të fabrikës së pasurimit të bakrit, e cila sipas perfaqësuesve të Bashkisë ka nevojë urgjente për ndërhyrje përmirësuese dhe rehabilituese.

**Zonat ekonomike:** ky lloj zonimi identifikon ato territore pranë qytezës së Fushë Arrëzit të cilat mund të akomodojnë aktivitete të ndryshme ekonomike, të cilat janë të pozicionuara kryesisht përgjatë rrugës kryesore nacionale, pranë ish zonave ekonomike të sharrave apo magazinave të vjetra.


**Zonat rurale:** ky zonim identifikon territoret përreth qytezës, rehabilitimi urban i të cilave duhet të paraprihet nga përgatitja e studimeve të pjesshme urbane.

**Zonat e Gjelbra:** territoret të cilat duhet të ruhen dhe të promovohen gradualisht në hapësira të gjelbra në shërbim të popullsisë vendore të qytezës.

Këto instrumente të paraqitura në mënyrë skematike orientojnë studimet e sipërpërmendura në bazë të prioriteteve dhe të planeve të veprimit siç përcaktohen në këtë Plan Strategjik.









## Forma dhe Metodologjia e Zbatimit të PSZH

Bashkia Fushë-Arrëz, nëpërmjet Kryetarit dhe Administratës Vendore, është përgjegjësjë kryesore për zbatimin e Planit. Për të rritur eficiencën e këtij procesi është e nevojshme marrja e masave si më poshtë:

- Ngritja e grupit të zbatimit dhe monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Fushë-Arrëz, brenda strukturës administrative ekzistuese, i cili do të jetë përgjegjësi kryesor për koordinimin dhe zbatimin e nismave dhe aktiviteteve të propozuara në Planin e Veprimit. Në varësi të buxhetit të Bashkisë, grupi mund të përbëhet nga përfaqësues të zyrave të ndryshme të administratës apo edhe nga specialistë të angazhuar rishtazi në këtë strukturë. Në të dy rastet, grupi duhet të jetë nën lidhshirin e Kryetarit të Bashkisë. Në këtë mënyrë sigurohet vazhdimësia dhe lidhja e Planit Strategjik të Zhvillimit me proceset e planifikimit dhe buxhetimit vjetor.
- Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Departamentit të Koordinimit Zhvillimit në Bashkinë Fushë-Arrëz, i cili do të angazhohet me përgatitjen e studimeve dhe projekt-propozimeve të nevojshme për financim në funksion të aktiviteteve të propozuara sipas çdo fushe.
- Riorganizimi administrativ i Bashkisë Fushë-Arrëz duke u bazuar në veprimet dhe kërkesat e identifikuara në Planin e Veprimit të propozuar si, krijimi i grupeve të punës për përgatitjen e projekt-propozimeve, organizimi dhe monitorimi i seminareve apo takimeve me pjesëmarrjen e aktorëve vendorë për çështje të buxhetimit, arsimit, bujqësisë, mjedisit etj; organizimi dhe moderimi i "shoqërive funksionale" në bashkëpunim me njësitë vendore fqinje etj..

- Fokusimi në forcimin e strukturave administrative që merren me ndjekjen e angazhimeve strategjike në kuadër të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe monitorimin e performancës.
- Përmirësimi i bazës së të dhënave territoriale, financiare dhe infrastrukturore në Bashki për t'i paraprirë përgatitjes së një serie projektesh apo studimesh të nevojshme për zbatimin e mundshëm të Planit Strategjik të Zhvillimit.
- Rritja e kapaciteteve dhe e nivelit të angazhimit të stafit të Bashkisë Fushë-Arrëz sidomos në aspektin e menaxhimit dhe monitorimit të territorit dhe infrastrukturave fizike nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme apo edhe përmirësimit të sistemit të raportimit dhe vlerësimit.
- Institucionalizimi i raporteve periodike të çdo zyre të administratës lidhur me ecurinë e zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit.

Zbatimi me sukses i Planit Strategjik të Zhvillimit në Bashkinë Fushë-Arrëz ka nevojë për konsolidimin e një sistemi të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi periodik. Në këtë mënyrë bëhet i mundur evidentimi i problemeve që mund të hasen gjatë zbatimit të Planit të Veprimit si dhe përcaktimi i ndryshimeve apo adaptimeve të nevojshme. Plani Strategjik i referohet një periudhe të shkurtër kohore, 2008-2014, dhe në këtë mënyrë është tepër e rëndësishme që të shoqërohet me një proces të vazhdueshëm vlerësimi dhe përshtatjesh të nevojshme.

Bazuar në Ligjin për Financat Publike, përgatitja e Projekt Buxhetit për tre vitet në vazhdim është një proces që duhet të finalizohet në muajin Korrik të çdo viti. Ky Projekt Buxhet bazohet në Udhëzimin e Qeverisë për përgatitjen e Projekt- Buxhetit të të gjitha njësive vendore në periudhën

Qershor-Korrik. Ky Projekt- Buxhet parashikon shpenzimet dhe investimet e Bashkisë Fushë-Arrëz për tre vitet në vazhdim, ndërsa Plan-Buxheti, i cili përgatitet dhe miratohet nga Këshilli Vendor si dhe nga Prefektura Shkodër brenda Dhjetorit, trajton vetëm vitin pasardhës. Përgatitja e Projekt Investimeve për Grantet Konkurruese është një proces që duhet të përfundojë deri në 1 Nëntor të çdo viti. Plan-Buxheti vjetor mund ose jo të përfshijë këto projekte në strukturën e tij.

Skema e Propozuar e Monitorimit të Plani Strategjik të Zhvillimit

Aktiviteti i Propozuar	Afati Kohor (për çdo vit)	Aktorët Përgjegjës	Lidhja me Planifikimin dhe Buxhetimin Vjetor
Vlerësimi 6-mujor i aktiviteteve të Planit të Veprimit të PSZH-së. Përgatitja e Progres-Raportit	Prill-Maj	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit	Duke u bazuar në rezultatet e 6-mujorit, Bashkia mund të përcaktojë ndryshimet në Projekt-Buxhetin që dorëzohet në Korrik.
Takime publike me qytetarët për rezultatet e zbatimit të PSZH-së.	Qershor-Korrik W	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit	Ndikojnë në adoptimet e nevojshme të aktiviteteve në Plan-Buxhetin final
Takim i stafit të administratës së Bashkisë për të diskutuar progresin si dhe ndryshimet e nevojshme.	Tetor-Nëntor	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit – Kryetari i Bashkisë	Takimi do të finalizojë ndryshimet dhe adoptimet e nevojshme të Planit të Aktiviteteve që do të reflektohen në Buxhetin e ri vjetor të Dhjetorit.
Takim vjetor për Vlerësimin dhe Monitorimin e PSZH-së. Përgatitje e Raportit Vjetor	Nëntor	Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit – Kryetari i Bashkisë	Takimi final i paraprin finalizimit dhe dorëzimit të Buxhetit Vjetor të Bashkisë.

Në fund të çdo vlerësimi Grupi i Punës duhet të dorëzojë një raport përmbledhës i cili do të paraqitet para Këshillit të Bashkisë Fushë-Arrëz. Ky i fundit ruan të drejtën që për çdo rast të bëjë kërkesë për raportim shtesë nëse e gjykon të nevojshme.



# PLANI STRATEGJIK IZHVILLIMIT TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ

P ë r m b l e d h j e